



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Buletini Javor II

18 Dhjetor 2014

Të dhëna nga monitorimi:

INPO ka vazhduar monitorimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, degët në Kaçanik dhe në Shtërpcë, në kuadër të projektit “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”. Gjatë periudhës prej 15 nëntor deri me 15 dhjetor janë monitoruar gjithsej shtatëmbëdhjet (17) seanca, prej tyre shtatë (7) seanca për vepër penale, dhjetë (10) për çështje civile. Në këto seanca është vërejtur një numër më i madhë i qytetarëve të interesuar për të marrë pjesë. Megjithatë, shumica prej tyre janë familjarë të pjesëmarrësve në gjykim, praktikant të Gjykatës, nxënës të shkollave të mesme, apo monitorues të ftuar nga organizata INPO.

Të dhëna statistikore:

Pjesëmarrja e qytetarëve në seanca sipas çështjes:

Çështja e Gjykuar	Numri i pjesëmarrësve
Vepër Penale	80
Kontest Civil	10

Me rëndësi është të ceket se në një prej senancave të gjykimit të një vepre penale në Gjykatën Themelore, Dega Kaçanik, pjesëmarrës kanë qenë katërdhjetë (40) nxënës të shkollës së mesme ekonomike të kësaj komune.

Pjesëmarrja e qytetarëve sipas vendit:

Vendi	Numri i pjesëmarrësve
Gjykata Themelore Ferizaj	45
Dega Kaçanik	40
Dega Shtërpcë	5

Gjatë kësaj periudhe kemi vërejtur se në shumicën e rasteve seanca është zhvilluar në zyre të Gjykatës të procedurës. Megjithatë, në krahasim me periudhën e mëparshme, vërejmë se në rastet kur parashihet pjesëmarrje të qytetarëve të tjerë, apo kur janë të paralajmëruar pjesëmarrja e nxënësve të shkollave të mesme, senacat zhvillohen në salla të gjykimit.

Debati në TV TEMA me temë “Transparenca në Gjykatën Themelore në Ferizaj”

Në fund të muajit nëntor, në TV Tema është mbajtur një debat televiziv, ku pjesëmarrës kanë qenë: U.d. i Kryetarit të Gjykatës Themelore, një avokat, përfaqësues i Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj dhe përfaqësuesi i INPO-së. Përfundime të rëndësishme të debatit ishin rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe informimi i tyre, ku u kërkuar që të gjitha vendimet e gjykatës të publikohen në një faqe të internetit zyrtarë të gjykatës.

Iniciativa për Progres, Projekti “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”

“Ky buletin u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e INPO-s dhe nuk pasqyron deomos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara”